



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi
Mbledhja nr. 03 -2009
Prishtinë, më 03 shkurt 2009, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni, Adem Salihaj, Ramadan Gashi, Kolë Berisha, Armend Zemaj, Ibrahim Makolli, Džezair Murati, Adem Hajdaraj dhe Selvije Halimi.

Munguan: Branislav Grbiq dhe Bajram Kosumi.

Të pranishëm: Reshit Gashi – NDI, Lejla Selimi OSBE, Ramadan Islami – OSBE dhe Rrezarta Ahmeti.

Nga stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Sulltane Gashi.

Mbledhjen e kryesoi Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit.

RENDI DITËS

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 27 janarit 2009;
3. Shqyrtimi i Planit të punës për vitin 2009;
4. Shqyrtimi i Raportit të punës të Komisionit për vitin 2008;
5. Shqyrtimi i Projektregullores së punës të Kuvendit të Kosovës;
6. Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Xhavit Haliti lidhur me Rregulloren e punës
7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – Në fillim të mbledhjes i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe i falenderoi organizatat që e mbështesin punën e Komisionit. Shpreson se kjo mëshitetje do të vazhdojë edhe në të ardhmen. I njoftoi të pranishmit për rendin e ditës.

Anëtarët e Komisionit propozuan që mbledhjet e rregullta të Komisionit të mbahen ditën e hënë, në orën 14 dhe jo si deri më tash, që janë mbajtur të martën, për arsye se ky orar u përshtatet të gjithë anëtarëve të Komisionit.

Propozimi u miratua nga Komisioni.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 27 janarit 2009

Kryetari – I pyeti anëtarët e Komisionit a kanë vërejtje eventuale për procesverbalin.

Procesverbali u miratua me vërejtjen e Adem Salihajt, që kërkoi të përfshihen propozimet për ndryshime dhe plotësime të Rezolutës, të paraqitura me shkrim, që duhet të jenë pjesë e këtij procesverbali.

3. Shqyrtimi i Planit të punës për vitin 2009

Kryetari - Duke diskutuar për shqyrtimin e Planit të punës për vitin 2009, ndër të tjera shtoi se Komisioni edhe sivjet do të ketë shumë punë. Në bazë të Planit të punës për këtë vit në Komision do të vijjnë 20 projektligje për t'u shqyrtuar.

Adem Salihaj - Duke u ndërlidhur me parafolësin shtoi se ky komision është i stërngarkuar me ligje. Duhet të kemi mbështetje më të madhe se komisionet e tjera, sepse ka edhe komisione që brenda një viti i procedojnë ndoshta vetëm katër ligje, prandaj trajtimi nuk do të duhej të ishte i njëjtë. Ky komision do të duhej të kishte kushte më të mira për punë.

Armend Zemaj – E ngriti çështjen e raportimit para Komisionit se a duhet të raportojë vetëm ministri i Drejtësisë apo edhe ministrat e ministrive të tjera.

Ibrahim Makolli – E ngriti çështjen e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit që nuk figuron në Planin e punës të Komisionit.

Selviqe Halimi - Shtoi se para Komisionit raporton secili ministër për fushëveprimin e vet, ndërsa për Ministrinë e Drejtësisë kjo dihet. Komisioni mund ta ftojë secilin ministër të raportojë para Komisionit për fushëveprimin e vet.

Kryetari – Për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit nënvizoi se në kuadër të këtij plani të punës është me interes të mbikëqyren dy ligje, njëri në mars dhe tjetri në tetor. Sa i përket raportimit para Komisionit, raporton ai që e sponsoron projektligjin.

Dzezair Murat – Në vizitën e Kroaci që e bëmë me Kryesinë e Kuvendit, kam parë shumë praktika që do të mund të barteshin edhe te Komisioni ynë, sidomos ato për hartimin e ligjeve. Vizita e Komisionit tonë në Kroaci ishte me interes.

Kryetari - Duke e përfunduar shqyrtimin për pikën e parë të rendit të ditës për Planin e punës të Komisionit për këtë vit, i pyet të pranishmit a janë për këtë plan të punës.

Plani i punës për vitin 2009 u miratua nga Komisioni.

4. Shqyrtimi i Raportit të punës të Komisionit për vitin 2008

Kryetari – Në këtë pikë të rendit të ditës shtoi se Raportin e punës të Komisionit për vitin 2008 e kemi pasur që disa ditë. Nëse nuk keni ndonjë vërejtje po e miratojmë.

Raporti i punës i Komisionit për vitin 2008 u miratua pa ndonjë vërejtje.

5. Shqyrtimi i Projektregullore së punës të Kuvendit të Kosovës

Kryetari - Lidhur me shqyrtimin e Projektregullore së punës të Kuvendit, ndër të tjera, shtoi se përkufizimet duhet të jenë në kreun I të dispozitave të përgjithshme dhe jo në shtojcën e Rregullore. Propozimi u miratua nga Komisioni. Kryetari shtoi se në tërë tekstin e Rregullore së punës do të ishte mirë të propozohej që të përdoret fjala neni dhe jo rregulla. Ky propozim u miratua.

Rregulla 14.5 është propozuar të riformulohet si vijon: Shkarkimi i kryetarit të Kuvendit ose i anëtarit të Kryesisë së Kuvendit, me propozimin e grupit parlamentar, që e ka emëruar, bëhet sipas procedurës së zgjedhjes së tyre. Propozim u miratua nga Komisioni. Te rregulla 42 rreth diskutimit të deputetëve për tri minuta, pati më tepër diskutime rreth kësaj rregulle. Ramadan Gashi pati rezerva për këtë rregull, por u miratua në Komisionin për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Punës së Kuvendit. U tha se kjo rregull është e tepërt.

Adem Salihaj - Theksoi se deklaratimet e deputetëve duhet të jenë të rëndësishme dhe mendoj se kjo është demokratike. Unë e përkrah rregullën 42, por nuk duhet të keqpërdoret kjo mundësi nga ana e deputetëve.

Ibrahim Makolli - Ndër të tjera shtoi se rregulla 42 është më e mira në këtë rregullore. Kështu është edhe në shumë vende demokratike. Jam që kjo rregull të mbetet kështu si është.

Selvije Halimi - Shtoi se nuk është e qartë ç'ka dashur hartuesi me këtë rregullore. Nuk është mirë të merren tri katër modele të rajonit dhe të hartohet në bazë të tyre një rregullore e punës. Unë mendoj se rregulla 42 duhet të hiqet.

Armend Zemaj - Ndër të tjera vuri në dukje se logjikisht është mirë të diskutojmë si deputetë për këtë rregullore. T'ia japim propozimet tona Komisionit për Mandate, Imunitete dhe për Rregullore të Punës të Kuvendit.

Adem Hajdaraj – Vlerësoi se është mirë të mbetet rregulla 42, sepse i jep deputetit më shumë mundësi.

Në këtë pikë të rendit të ditës, për rregullën 42, disa anëtarë donin të hiqej, disa të mbetej. Propozimet e Komisionit do t'i dërgohen Komisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Punës të Kuvendit.

Komisionit Funkcional për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Punës do t'ia dërgojmë edhe materialin e fushëveprimit e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

6. Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Xhavit Haliti lidhur me Rregulloren e punës

Kryetari - Sugjeroi që vërejtjet e deputetit Xhavit Haliti, t'i dërgohen Komisionit Funkcional për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Punës të Kuvendit. Ky propozim u miratua nga Komisioni.

7. Të ndryshme

Në këtë pikë të rendit të ditës u shqyrtuan edhe disa projektligje për bazën juridike kushtetuese si:

1. Projektligjin për auditimin e brendshëm;
2. Projektligji për zonat ekonomike;
3. Projektligji për rezervat shtetërore të mallrave;
4. Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/17 për mbrojtjen e konsumatorëve;
5. Projektligjin për protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës.

E hartoi stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni